



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:206104
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05838589

CML.nr.5/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - përmbartimore të kreditorit: A. B. nga F., të cilin e përfaqëson Burhan Qosa, avokat në F., sipas autorizimit, kundër debitorës: Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, në Prishtinë, në procedurën e përmbartimit sipas dokumentit përmbartimor duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7670/2022, të datës 06.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7670/2022, i datës 06.02.2024, ashtu që: mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.273/21 i datës 18.10.2022.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.273/21 i datës 18.10.2022, është vendosur: Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbartimit .., i datës 30.08.2021, i lëshuar nga përmbartuesi privat B. T. nga F. dhe mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit..., i datës 30.08.2021.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7670/2022, të datës 06.02.2024, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar ankesa e debitorës Qeveria e Republikës së Kosovës -

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.273/21 i datës 18.10.2022, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: Pranohet i bazuar prapësimi i debitorës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, shfuqizohet (vihet jashtë fuqie), urdhri për lejimin e përmbarimit..., i datës 30.08.2021 dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore, ndërsa propozimi për përmbarim i kreditorit A. B. nga F. *refuzohet i pabazuar*. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë Prokurori i Shtetit, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 247 paragrafi 1 pika b) e lidhur me nenin 184 të LPK-së, dhe nenin 22 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj në tërësi kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë si të bazuar, të prishet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7670/22, i datës 09.02.2024 dhe lënda t'i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka pasur.

Për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 250 të LPK-së, ka caktuar seancë dëgjimore/seancën e kolegjit më datë 28.05.2024, në të cilën ka marrë pjesë i autorizuari i kreditorit avokat Burhan Qosa, sipas autorizimit, ndërsa në seancë nuk kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit dhe debitorja edhe pse të njëjtit ishin të ftuara në mënyrë të rregullt.

Në seancën e kolegjit i autorizuari i kreditorit ka deklaruar se mbesë pranë kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë me arsyetimin se e njëjta është e bazuar në ligj. Konsiderojë se Gjykata Supreme duhet ta shqyrtojë sipas detyrës zyrtare meritorisht çështjen dhe të mos e kthejë në rishqyrtim, por ta lë në fuqi aktvendimin e shkallës së parë, sepse në këtë fazë të procedurës kjo çështje ka përfunduar me urdhrin ... të datës 04.10.2023.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 245, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori më datë 30.08.2021, pranë zyrës së përmbaruesit privat ka paraqitur propozim për përmbarim sipas dokumentit përmbarimor, duke kërkuar më saktësisht si në propozimin për përmbarim.

Përmbaruesi Privat duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me urdhrin përmbarimor ..., të datës 30.08.2021, duke vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet si vendim përmbarues.

Kundër urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat, debitori ka paraqitur prapësim, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e saj PPP.nr.273/21 të datës 18.10.2022, ka vendosur që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim ... i datës 30.08.2021, i lëshuar nga përmbarruesi privat B. T., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarrimore ngase përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin, në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.2, dhe nenit 24, par 3, të LPP-së.

Ka shtuar se sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se e konteston në tërësi si të pabazuar urdhrin për përmbarrim, vendimin përfundimtar Nr. ..., të datës 18.06.2019, si dhe aktin e vlerësimit të datës ..., sepse nuk kanë titull ekzekutiv, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara, për shkak se vendimi përfundimtar Nr. ..., i datës 26.03.2019 dhe akti i vlerësimit të Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, i datës 21.01.2019, konsiderohen dokumente përmbarrimore në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe nenit 24, paragrafi 3, të LPP-së, për arsye se vendimi përfundimtar i cekur më lart siç konstatohet nga dispozitivi i tij në pikën 2, të vendimit në fjalë është paraparë dhe është pjesë integrale edhe akti i vlerësimit të paluajtshmërive të kreditorëve në këtë rast akt ky i lëshuar nga Ministria e Financave, në të cilin është përcaktuar shprehimisht emri dhe mbiemri i kreditorëve, numri i ngastrave kadastrale si dhe shumat e mjeteve të cilat duhet paguar kreditorëve. Po ashtu vendimi në fjalë është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ky fakt është përcaktuar shprehimisht edhe në pikën 4 të vendimit. Përveç tjerash në vendimin përfundimtar gjegjësisht në pikën 7 të tij është paraparë edhe detyrimi i debitorit për ta paguar shumën e kompensimit për shpronësim brenda afatit prej dy viteve. Andaj, të gjitha faktet e përmendura më lart e bëjnë vendimin përfundimtar Nr. ..., të datës 26.03.2019 dhe aktin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, të datës ..., dokumente përmbarrimore të parapara në nenin 22, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe nenit 24, paragrafi 3, të LPP-së, për arsye se siç konstatohet nga shkresat e lëndës vendimet e cekura më lart janë nxjerrë në pajtim me rregullat e procedurës administrative.

Po ashtu sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të debitorit në prapësim, se vendimi përfundimtar, nuk është i përshtatshëm për përmbarrim edhe pse i njëjti i referohet vendimit Nr. ..., të datës 18.06.2019, i cili nuk është vendimi përfundimtar por është vendim me të cilin është miratuar vlerësimi i ndikimit socio - ekonomik për pronat e paluajtshme të pronarëve, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar dhe të paqëndrueshëm sepse nga vendimi përfundimtar Nr. ..., i datës 26.03.2019, dhe nga akti i vlerësimit i lëshuar nga Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, vërtetohet se vendimi përfundimtar dhe akti i vlerësimit janë në tërësi të përshtatshme për përmbarrim dhe në pajtim me nenin 27, paragrafi 1, të LPP-së, për shkak se në vendimin përfundimtar, në pikën 4 siç është sqaruar edhe më lart është paraparë se pjesë e vendimit përfundimtar është edhe akti i vlerësimit i cili e përmban emrin dhe mbiemrin e kreditorit, adresën e tij, shumën e mjeteve e cila duhet paguar kreditorit si dhe kohën e përmbushjes së detyrimit e që është periudha kohore brenda afatit prej dy viteve e cila është paraparë në pikën 7 të vendimit si në vijim: "Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim". Gjykata po ashtu konstaton se nga shkresat e lëndës, i autorizuari i kreditorit propozimin për përmbarrim e ka ushtruar në pajtim të plotë me nenin 38, paragrafi 1, të LPP-së,

sepse në propozimin për përmbarrim është treguar dokumenti përmbarrimor në kopje të vërtetuar, kërkuesin e përmbarrimit dhe debitorin, adresën e debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 22, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, nenit 24, paragrafi 3 dhe nenit 73, paragrafi 1, 2 dhe 3, të LPP-së.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, debitori ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.nr.7670/2022, të datës 06.02.2024, ka vendosur që ta aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, ndërsa e ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 22 paragrafi 1.2 e lidhur me nenin 23.2, e lidhur me nenin 24 paragrafi 3, nenin 71 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorëve i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë atë se çka konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbarrim dhe mbi cilën bazë mund të iniciohet procedura e përmbarrimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, lidhur me aprovimin ankesës së debitorit dhe shfuqizimin e urdhrin përmbarrimor P.nr. ... të datës 30.08.2021, pasi që aktvendimi i shkallës së dytë është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e debitorit dhe shfuqizuar urdhrin përmbarrimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e kufizuar, prandaj edhe vlerësohen si pretendime të bazuara, për arsye se:

Me nenin 245 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: “ Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh...”.

Me nenin 246 të LPK-së, përcaktohet se: “ Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritet nga prokurori publik, në pajtim me ligjin ”.

Me nenin 247 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktvendimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale”.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatës së shkallës së dytë, nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ajo nuk i ka zbatuar drejt dispozitat ligjore të nenit 22, nenit 24, nenit 27, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ndërsa, qëndrimin juridik, përkatësisht, aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë, e vlerësoi si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kështu, për faktin sepse, me vendimin përfundimtar Nr.07/95 të datës 26.03.2019, dhe aktit të vlerësimit të Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, i datës 21.01.2019, me të cilin ishte aprovuar shpronësimi përkatës, veç tjerash, me pikën 2 të tij, është paraparë se: “ Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interes, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në “Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimi ”. Gjithashtu, në pikën 7 të vendimit të lartcekur, është paraparë se “ Brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me vendim”. Ndërsa me vendimin Nr. ... të datës 18.06.2019, në pikën 5 dhe 6 është përcaktuar se: “ 5. Obligohet Ministria e Infrastrukturës t’i ofrojë Departamentit të Shpronësimit të gjitha dokumentet juridike (leje për shfrytëzim, pagesa etj., të nxjerra gjatë inspektimeve për respektim të brezit rrugor përgjatë këtyre rrugëve për pronat e pronarëve dhe zotërueseve të interesit konform Ligjit për Rrugët të Kosovës, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi. 6. Konform dokumentacionit nga pika 2 dhe 5 e këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë shumën e kompensimit të vlerësimit socio-ekonomik ”.

Nga ana e debitorës gjatë procedurës përmbartimore me mjete të goditjes (prapësimit dhe ankesës) janë ngritur pretendime edhe se dokumenti përmbartimor në bazë të cilët është lejuar përmbartimi nuk është titull përmbartimor sipas dispozitave të LPP-së, për shkaqet e theksuara në prapsim dhe ankesë, të cilat pretendime nuk janë pranuar si të themelta, sepse në procedurën përmbartimore gjykata i përmbahet parimit të rigorozitetit formal - juridik që nënkupton se vlerëson vetëm rrethanat nga të cilat varet lejueshmëria e përmbartimit dhe shkaqet që mund të përbejnë bazë të mjaftueshme për prapësim, ndërsa nuk lëshohet fare në vlerësimin e veprimeve që i referohen procedurës në të cilën është marr dokumenti përmbartimor.

Andaj nga të cekurat më lartë rezulton se, me nenin 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, veç tjerash, shprehimisht përcaktohet se dokumente përmbartuese janë edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurën administrative dhe aktprajtimi (mëtej:

ujdia), përkatësisht, me nenin nenit 27 paragrafi 1, përcaktohet se: “ Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”, si në këtë rast, ngase vendimi dhe akti i vlerësimit të lartcekur, përmbajnë, kumulativisht, të gjitha elementet që parasheh dispozita ligjore e lartcekur, prandaj vendimi përfundimtar i debitorës, konsiderohet, konform nenit 22 dhe 27 të LPP-së, dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim.

Në këtë kontekst sipas vlerësimit të kësaj gjykate, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se vendimi përfundimtar Nr. ... i datës 26.03.2019, dhe akti i vlerësimit të Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, i datës ..., në këtë rast është dokument përmbarues, kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: “ Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia) ”, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: “ Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”. andaj përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë lidhur me aprovimin ankesës së debitorit dhe shfuqizimin e urdhrin përmbarimor ... të datës 30.08.2021, në këtë rast është marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Përveç të cekurave në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorës nuk ka gjete se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: “ Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet ”. Në këtë rast debitorja me anë të prapësimin nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjëri nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbarimin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 245, 246 dhe 251 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
CML.nr.5/24, më datë 28.05.2024

Kryetari i kolegjit
Muhamet Rexha